



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**  
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

**OPINION MBI KANDIDATIN Z. BLENDAR MUSTAFARAJ**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më Vendimin nr.294, datë 17.12.2020 ka miratuar hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- ***Përgjegjës i Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë.***

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim u përcaktua 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë i Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 2 (dy) prokurorë.

Në datë 28.12.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurorit Bledar Mustafaraj, i cili ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në nenin 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi është apo jo në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër Komisioni për Zhvillimin e Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Bledar Mustafaraj, ushtron funksionin e magjistratit që prej datës 11.10.2004 kur është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ku edhe vazhdon të ushtrojë detyrën. Z.Musatafaraj ka mbuluar edhe detyrën e Zv/Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për disa vite. Ai ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 16 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë i komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me kriterin e cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë rezulton se:

- Nga mendimi i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me shkresën nr.12515 prot datë 28.12.2020 rezulton se komandimi i prokurorit Bledar Mustafaraj nuk ndikon në veprimtarinë normale të punës së kësaj Prokurorie.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duke konsideruar të përmbushura të gjitha fazat e procedurës së komandimit për pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë, i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

***Miratimin e opinionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për kandidatin prokuror Bledar Mustafaraj.***